



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.01/2018

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK) me seli ne Komunën e Klinës, të paraqitur kundër vendimit Nr. 58/2018, të datës 12.01.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të çregjistrimit të subjektit politik nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 17.01.2018, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHE si i pabazuar apeli i subjektit politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK), me seli në Klinë, i paraqitur kundër vendimit Nr.58/2018 i datës 12.01.2018, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, me datë 15.01.2018 ka pranuar një apel nga subjekti politik FDBK, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me numër protokolli 58/2018 të datës 12.01.2018, me të cilën thekson se KQZ me datën 12.01.2017 ka marrë vendimin me nr. 58/2018 për çregjistrimin e subjektit politik FDBK për shkak te mos përmbushjes se obligimeve që dalin nga neni 15 i Rregullës 01/2013 për Regjistrimin dhe veprimin e partive politike, në bazë të të cilit nen është subjekti politik është dashur që të dorëzoj njoftimin apo ndonjë dokumentacion që ka mbajtur kuvendin zgjedhor. Parashtruesi i apelit thekson se me vendimin e KQZ-së është njoftuar ditën e shtune me datën 13.01.2018 dhe se i njëjti kërkon që të ndryshohet vendimi i KQZ-së për çregjistrim pasi qe i njëjti nuk ka qenë i njoftuar me rregullën zgjedhore si dhe si arsye për lëshimin e afateve për mos mbajtjen e kuvendit ne fjale thekson se ka qene gjendja shëndetësore e kryetarit te subjektit te tyre politik.

Në përgjigjen e ofruar nga KQZ, me nr. Protokolli 82/2017 të datës 16.01.2018 theksohet se me datën 23.11.2017 me rekomandimin e Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike KQZ-ja ka pezulluar nga regjistri i subjekteve politike partin politike Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK) për mos mbajtje të kuvendit zgjedhor ashtu siç parashihet me nenin 15 të Rregullës Zgjedhore 01/2013 për regjistrimin dhe veprimin e partive politike dhe i ka dhënë afat shtese prej dyzet e pesë (45) ditëve që të mbaj kuvendin zgjedhor, ku me të njëjtën date e ka njoftuar subjektin politik në fjalë me vendimin e KQZ-se dhe ne pajtim me nenin 6 paragrafi 1 germa aa) të Rregullës 01/2013 duke i dhënë afat shtese prej dyzet e pesë (45) ditëve që të mbaj kuvendin. Me tutje në përgjigje theksohet se me kalimin e afatit prej dyzet e pesë (45) ditëve, Zyra i ka rekomanduar KQZ-së që ta çregjistroj partinë politike, ku vendimi për çregjistrim është marre në mbledhjen e datës 12 janar 2018 konform nenin 8 paragrafi 1 germa e) për mos përmbushjen e nenit 15 paragrafi 1 germa a) të po të njëjtës Rregull, pasi që partia politike e lartcekur nuk ka vepruar sipas afatit të shtuar paraprakisht të përcaktuar me vendimin e KQZ-se për pezullim të datës 23.11.2017 Gjithashtu në përgjigje theksohet se Zyra me datë 12.01.2018 për vendimin e KQZ-së, ka njoftuar përfaqësuesin e subjektit politik dhe kryetarin e subjektit politik dhe se i njëjti vendim është publikuar edhe në ueb faqen e KQZ-se.

KQZ, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Vendimin e KQZ-së për pezullim
- Vendimin e KQZ-së për çregjistrim
- Njoftimet elektronik lidhur me vendimet e KQZ-së.

Paneli, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka trajtuar si apel duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 12.01.2011 me numër protokolli 58/2018 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ-ZRPPC-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

PZAP, konstaton se KQZ-ja me vendimin me Nr.58/2018 të datës 12.01.2018, ka vendosur drejt kur ka bërë çregjistrimin nga Regjistri i Partive politike subjektin politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK).

Dispozita e nenit 15.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike ka përcaktuar që *"Partia e regjistruar politike mban kuvendin brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku dyzet e tetë (48) muaj"*.

Paneli konstaton nga shkresat lëndës, se subjekti politik Fronti Demokratik për Bashkim Kombëtar (FDBK), nuk i ka përmbushur obligimet ligjore të cilat parashihen me nenin 15 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013. Të cilat mos përmbushje ligjore i ka pohuar edhe vetë parashtruesi i apelit. Po ashtu Paneli ka

gjetur se KQZ-ja në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, pika (aa), të Rregullës Zgjedhore 01/2013 me vendimin me nr. 2347/2017 të datës 23.11.2017 e ka pezulluar nga regjistri i partive politike duke i dhënë afat shtesë subjektit politik në fjalë që në afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditësh, nga dita e pezullimit të mbaj kuvendin zgjedhor. Përkundër kësaj subjekti politik FDBK nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të dhëna me vendimin e lartpërmendur të KQZ-së.

Bazuar në këto që u theksuan më lartë PZAP konstaton se vendimi i KQZ-së me Nr.58-2018 i datës 12.01.2018, për çregjistrimin e subjektit politik FDBK nga regjistri i partive politike është i drejtë dhe i bazuar në nenin 8.1 pika e) Rregullës Zgjedhore 01/2013 pasi që subjekti politik në fjalë nuk vepruar sipas afatit të përcaktuar me vendimin e KQZ-së për mbajtjen e kuvendit zgjedhor, ndërsa pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara.

Për arsyet e cekura si më lartë e në pajtim me nenin 115.1 lidhur me nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr. 01/2018 më datën 17.01.2018

Kryesuesi i Panelit,
Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.